



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 07.02.2025

Nr: 69

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË BASHKISË
PUKË PËR PERIUdhËN 26 JANAR-01 SHKURT 2025**

Sot, më datë 07.02.2025 unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me

SUBJEKT: Bashkia Pukë

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Bashkisë Pukë për periudhën 26 janar deri më 01 shkurt 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 26 janar-01 shkurt 2025, Bashkia Pukë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve (NRI), 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- “Përmbledhje e veprimtarisë së organizuar në Michigan USA, me rastin e dorëzimit të titujve vendor të nderit, akorduar me VKB, me 27.12.2024 për personalitete të artit, kulturës dhe gazetarisë Pukjane dhe më gjerë”, raportuar në datën 30.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 31.1.2025.

Data: 07.02.2025 Nr: 69
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Bashkisë Pukë, për periudhën 26 janar – 01 shkurt 2025”

Nëpërmjet email-it, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Bashkisë Pukë një informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes.

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Bashkisë Pukë ka dërguar pretendimet, duke sqaruar se: *“Më datë 21.1.2025 pranë KQZ, Bashkia Pukë ka kryer një raportim aktiviteti me tematikë “Dorëzim i titujve vendor të nderit (Qytetar Nderi dhe mirënjohje e Bashkisë Pukë), për disa figura dhe personalitete me banim në Michigan, USA, që kanë dhënë një kontribut humanitar dhe patriotik për Pukën dhe në tërësi për çështjen Kombëtare Shqiptare”. Ky aktivitet është zhvilluar më datë 26.1.2025. Për sa i takon orarit, është në varësi të orës lokale zonale të SHBA-së, por kryesisht 13:00 deri më 17:00 me orën lokale. Sqarojmë se shpallja Qytetar nderi është bërë në muajin dhjetor me vendim të këshillit të Bashkisë Pukë. Në pritje të lejes tuaj për pasqyrim aktiviteti, nuk është bërë i mundur pasqyrimi i këtij aktiviteti pasi jemi kushtëzuar nga oraret zonale, pasi zhvillimi i veprimtarisë në Michigan, USA më datë 26.1.2025 përkonte më pas mesnatën e datës 27.1.2025 në Shqipëri. Më pas, ne rikërkuam më datë 30.1.2025 leje për publikimin e veprimtarisë së organizuar në Michigan më datë 26.1.2025. Ideja e kësaj kërkesë ka qenë pikërisht, për të bërë këtë publik veprimtarinë, meqë ne tejkaluam afatin e kërkesës. Raportimi i bërë më datë 30.1.2025 nuk ka konsistuar me zhvillimin e veprimtarisë më datë 31.1.2025, pasi kjo veprimtari është zhvilluar më datë 26.1.2025, por kemi kërkuar leje për pasqyrim aktiviteti për veprimtaritë që ju kishte kaluar afati”.*

Pas hetimit administrativ, u konstatua se Bashkia Pukë e ka raportuar fillimisht aktivitetin në datë 20.1.2025 për t’u zhvilluar në datë 26.1.2025, në përputhje me afatin e parashikuar nga ligji. Në datë 30.1.2025 e ka riraportuar në ndërfaqe me qëllimin e marrjes së lejes nga KQZ, për ta publikuar, në shkelje të afatit 5 ditor duke sqaruar se s’ka mundur ta publikoj më parë për shkak të ndryshimeve të fashës orare të Shqipërisë me SHBA.

Në këto kushte, vlerësoj se raportimi i parë i kryer është në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator, i ndryshuar. Gjithashtu, raportimi i dytë, nuk është në kushtet e shkeljes administrative për aq kohë sa nuk është zhvilluar, por në interpretim të gabuar të ligjit, është raportuar vetëm sepse veprimtaria do të postohet në media sociale.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Bashkisë Pukë.
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI